

TAKIM I PLATFORMËS SË PARTNERITETIT TË INTEGRIMIT EVROPIAN

Në datën 5 tetor Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme në vijim të takimeve të planifikuara për konsultim me Platformën e Partneritetit për Integrimin Evropian, zhvilloi një tjetër takim online me përfaqësues të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian për Kapitujt 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore” dhe 24 “Drejtësi, liri dhe siguri”.

Në takimin e kryesuar nga Drejtoresha e Drejtorisë së Integrimit dhe Negociatave, znj. Bano u diskutua rreth dokumentit “Masat prioritare në fushën e shtetit të së Drejtës” qëllimi i hartimit të së cilit është të paraqesë politikat kryesore që vendi ynë merr në procesin e negociatave për anëtarësim në BE.

Në këtë takim morën pjesë përfaqësues nga shoqëria civile, bota akademike dhe ekspertë të fushës të cilët pasi ishin njohur me dokumentin diskutuan në mënyrë aktive duke ofruar sugjerime dhe komente me qëllim përmirësimin e këtij dokumenti.

